



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KRYETARI

Nr. 1482/Prot.  
1

Shijak, më 23.03.2021

VENDIM

**“PËR MIRATIMIN E VENDEVE PUBLIKE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE  
PROPAGANDISTIKE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË”**





Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 79 , Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

V E N D O S:

1. Miratimin e vendeve publike, në territorin administrativ të bashkisë Shijak, për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , sipas listës bashkëlidhur.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në:
  - Distancë prej më shumë se 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo e subjektit zgjedhor përkatës;
  - Fasadat e godinave të banimit, institucionet publike apo ambientet rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, pemë dhe shtylla ndriçimi;
  - Mjete që operojnë në transportin publik.
3. Ngarkohet policia bashkiake në bashkëpunim me policinë e shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Një kopje e vendimit i komunikohet Komisarariatit të Policisë Shijak dhe Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të bashkisë Shijak.

KRYETARI  
Elton Arbana



Nr.	Pozicioni gjeografik itabeles ne KRGJSH	Kordinata x	Kordinata y	Foto
1	Hyrja ne Autostradë Dr-Tr ne Sukth	41.366364	19.553964	
2	Mbikalimi Katund Sukth Tr-Dr	41.360957	19.540736	
3	Autostrada Tr-Dr Tek Sinani	41.356773	19.530469	
4	Mbikalimi Fllakes Autostrada Dr-Tr	41.349251	19.513229	
5	Dalja ne Sukth Autostrada Dr-Tr	41.362875	19.546039	